




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 4463 Prot.

Durrës, më 13 /03/2026

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike Publike

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE



Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, Kreu VI “Njoftimi i Vendimit”, pika 3, b) “Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit”, si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin online/në faqen zyrtare të DPD-së, të subjektit/shtetasit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar: **Njoftimi i Vendimit Administrativ të Degës së Doganës Durrës.**

Nr	Vendimi Administrativ		Subjekti debitor		Detyrimi	Penalitete	SHUMA
	Nr.	Data	Emri	Nipti			
1	405	09.03.2026	SHPETIM SHARRI	L00017733P	35,313	0	35,313

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI
DENIS SHABANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS DURRËS

Nr. 400 prot.

Durrës, më 07/3 2026

V E N D I M N R. 405

Sot, në datë 06.03.2026, unë, Kryetari i Degës së Doganës Durrës, pasi shqyrtova, materialin e plotë bashkëlidhur shkresës me nr.1268/50 Prot., datë 07.10.2025 (Nr. 17658 Prot., datë 13.10.2025 i DDDurrës) me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e përputhshmërisë”, në vijim të Urdhërit Nr.18464/14 Prot., datë 28.10.2025 “Urdhër për analizimin, vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të “Auditimit të Përputhshmërisë” me Nr.1268/49, datë 07.10.2025 (nr.18464/13 Prot., datë 08.10.2025 i DDD) të ushtruar nga KLSH në Degën e Doganës Durrës”; Nr.18464/27 Prot., datë 09.12.2025 “Në vijim të Urdhërit Nr.18464/14 Prot., datë 28.10.2025...”, si dhe shkresës Nr.551 prot., datë 13.01.2026; me objekt “Dërgim formularë rivlerësimi për vendimarrje sipas aneksit 4.44”, të mbajtur nga Grupi i Punës, lidhur me deklaratat doganore që i përkasin subjektit “Shpetim Zharri” me Nipt L00017733P,

K O N S T A T O V A S E :

Pranë Degës së Doganës Durrës është ushtruar kontroll nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën e veprimtarisë nga data 01.07.2022 deri më datë 31.12.2024.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën me nr.1268/50 Prot., datë 07.10.2025 (Nr. 17658 Prot., datë 13.10.2025 i DDDurrës) me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e përputhshmërisë”, është konstatuar se :

- Auditimi i procedurave të ndjekura gjatë veprimtarisë së deklarimit doganor në lidhje me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave për periudhën nën auditim.

- Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruara në Kapitullin *73, 84 dhe 85 * të Nomenklaturës së Mallrave në RSH për mallin e deklaruar në kapitujt respektive “Artikuj metalik Makineri, pajisje të përdorura” konstatohet se dokumentacioni tregtar bashkangjitur praktikave doganore të mëposhtme nuk përmbush edhe kushtet për trajtim vlerësimi sipas metodës së transaksionit sipas; nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Nisur nga sa më sipër, artikujt e përdorur të kapitujve të sipërcituar të pasqyruar në material duheshin rivlerësuar jo më pak se 0.7 €/kg. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore të këtyre artikujve konstatohet se edhe pse artikujt janë deklaruar nën çmimin e skrapit të publikuar te bursa "Metal Buletin", janë trajtuar me transaksion.

Për sa më sipër, për deklaratat doganore me të dhënat e evidentuara në tabelë, që i përkasin subjektit “Shpetim Zharri” me Nipt L00017733P kanë lindur detyrime doganore shtesë bazuar në legjislacionin doganor.(Aneksi 4.44)

Viti	Proc	DAV	Nipt	Kap	Artikuj	Pesha	Deklaruar EU/kg	Rivleresim es/kg	Rritlogaritje detyrimi/leke	Agjensi
2024	4000	57374	L00017733P	73	Artikuj/metalik/perforur	2260	0.23	0.70	35313	J100

Në zbatim të Urdhërit Nr.18464/14 Prot., datë 23.10.2025 "Urdhër për analizimin, vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të "Auditimit të Përputhshmërisë" me Nr.1268/49, datë 07.10.2025 (nr.18464/13 Prot., datë 08.10.2025 i DDD) të ushtruar nga KLSH në Degën e Doganës Durrës", të Kryetarit të Degës së Doganës Durrës, Nr. 18464/27, datë 09.12.2025 si dhe mbështetur në shkresën Nr.18464/24 Prot., datë 10.11.2025 të mbajtur nga Zyra përaktëse pranë Degës së Doganës Durrës, me shkresën nr.21675 prot., datë 12.12.2025, u morën masa për njoftimin e subjektit "Shpetim Zharri" me Nipt L00017733P si dhe agjensisë doganore "Best Choice" me Kod J100, lidhur me konstatimin me qëllim fillimin e procedurës së hetimit administrativ, nga ana e Autoritetit Doganor.

Per kete qellim, nga ana e Grupit të Punës me shkresën nr.551 Prot., datë 13.01.2026 me lëndë "Dërgim formularë rivlerësimi për vendimarrje sipas aneksit 4.44", është përcjellë Formulari Mbi Rivlerësimin Doganor, ku është konkluduar se, ciçojmë: "Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës doganore rezulton se nga ana e sektorit të vlerës kjo praktikë nuk është trajtuar me transaksion lidhur me vlerën e mallit jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr.03, dsatë 23.01.2018 "Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore", në bazë të nenit 66-70 të KD, pasi dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk e justifikon metodën e vlerësimit me transaksion lidhur me vlerën e deklaruar të mallrave për efekte doganore subjektet e tjera kanë zhdoganuar në praktikën doganore të ndryshme këtë artikull, janë llogaritur detyrime doganore shtesë, duke mospranuar transaksionin, nga e njëjta origjinë.

Për këtë arsye, duke u ndodhur në kushtet e plotësimit të kërkesave të neneve 66-70, të Ligjit 102/2014 datë 31.7.2014 *Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.03, datë 23.01.2018 "Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore", duhet të kalohet në metodën dytë të vlerësimit e cila është bazuar në vlerën e transaksionit të mallrave identik, shitur për eksport në Republikën e Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht në të njëjtën kohë si mallrat që po vlerësohen, për të cilat është pranuar më parë transaksioni- subjekti duhet të paguajë detyrimet doganore të shmangura.."

- Diferenca e detyrimit doganor rezultuar për t'u paguar është në Shumën totale 35 313 lekë.


Për sa më lart konstatuar, është njohur si subjekti ashtu edhe përfaqësuesi tij doganor nëpërmjet shkresës nr.551/19 prot., datë 16.01.2026, nëpërmjet shërbimit postar. (dokumentacioni i plotë bashkëlidhur)

Në përfundim, bazuar në Informacion e sipërcituar nr.551 prot., datë 13.01.2026 si dhe të gjithë dokumentacionit bashkëlidhur, në kushtet e plotësimit të kërkesave të nenit 49, neneve 66-70 në mbështetje të Kreut III "Vlera për qëllime doganore", nenit 99, 103, 273, 276 e vijim të Ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i RSH" të ndryshuar, Udhëzimit nr.03 datë 23.01.2018 "Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore" të Ministrit të Financave, VKM-së nr.651 datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" të ndryshuar, Udhëzimit nr.05 datë 26.01.2018 "Mbi procedurat standarte të funksionimit të Sektorit të Vlerësimit Qëndror", Urdhërit Nr.5, datë 12.01.2024 (Nr.814/1 Prot., datë 12.01.2024) "Manualit Udhëzues mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës", akteve ligjore dhe nënligjore të zbatim të tyre,

V E N D O S A :

1. Subjekti “**Shpetim Zharri**” me Nipt **L00017733P** duhet të paguajë diferencën e pagesës së detyrimit të importit në shumën prej **35 313 lekë**, rezultat për t’u paguar lidhur me praktikat doganore për sa më lart trajtuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në plotësim të kërkesave të nenit 281 e 282 të Kodit Doganor brënda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi (...pagesa 100% të detyrimit të importit rezultat për t’u paguar...).
3. Për të vijuar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi ngarkohen Zyra Aposterior, Zyra e Financës dhe Borxhit, këtu.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Denis SHABANI

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains text in Albanian, including "REPUBLIKA E SHqipëRIE" and "DIREKTORATI I DOKANAVE". The signature is a stylized, cursive script.

